



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0408**  
**Data e Vendimit: 05.07.2023**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së OE NIKA PrO- Ing SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i objektit të QPD-QRA në Malishevë” me numër të prokurimit 214-23-1473-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj me datën: 05/07/2023, mori këtë:

## **Vendim**

Hedhet si jo e plotë ankesa OE “NIKA PrO- Ing” SH.P.K e datës 16.06.2023 (protokoll 408/2023), për aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i objektit të QPD-QRA në Malishevë” me numër të prokurimit 214-23-1473-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme.

2. I lejohet autoritetit kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme, që të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i objektit të QPD-QRA në Malishevë” me numër të prokurimit 214-23-1473-5-1-1, inicuar nga AK Ministria e Punëve të Brendshme, përkitazi me këtë ankesë nëse nuk ka ankesë tjetër.

## **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik të e-prokurimi me datë 16.06.2023, tek rubrika e ankesave ka pranuar një ankesë nga OE “NIKA PrO- Ing” SH.P.K, për aktivitetin e prokurimit me “Ndërtimi i objektit të QPD-QRA në Malishevë” me numër të prokurimit 214-23-

1473-5-1-1, iniciuar nga Ministria e Punëve të Brendshme autoriteti kontraktues (AK).

Zyra e pranimit të ankesave pas pranimit të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka ofruar dëshminë siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së.

Nisur nga fakti, se Ankuesi, ankesës së lartcekur nuk i'a kishte bashkëngjitur konfirmimin e bankës për tarifën, zyrtarja për pranim të ankesave dhe protokollit përmes sistemit SML në të njëjtën datë (20.06.2023 dhe 21.06.2023) ia kishte kthyer njëjtën Ankuesit për plotësim duke i sqaruar, se e njëjta duhet të ridërgohet e plotësuar me konfirmim të bankës për tarifën e ankesës në fjalë. njëhrit ishte njoftuar se nëse nuk vepron sipas udhëzimeve të OSHP ankesa e tij do të hedhet si e palejuar.

Duke u bazuar në faktin se Ankuesi, nuk kishte ridërguar ankesën e tij OSHP edhe pse kishin kaluar disa ditë nga dërgimi për plotësim për hire të transparencës nëpërmjet emailit zyrtar të OSHP me, OSHP i drejtohet sërish Ankuesit me kërkesën që ankesa me nr. 408/2023 ta ridërgoj së bashku me konfirmimin e bankës si dëshmi të ankesës në fjalë, në mënyrë që të plotësohet kushtet për procedim të mëtutjeshëm. OSHP, sqaron se deri me 05.07.2023, nuk e ka pranuar ankesën e plotësuar sipas kërkesës së institucionit, duke mos ofruar dëshmi-konfirmim nga banka për tarifën e ankesës në fjalë.

Nga provat e prezantuara vlerësohet se ankesa e parashtruar nga OE “NIKA Pro- Ing” SH.P.K, e datës: 16.06.2023 (protokoll 408/2023), për aktivitetin e prokurimit me titull me “Ndërtimi i objektit të QPD-QRA në Malishevë” me numër të prokurimit 214-23-1473-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme konsiderohet si e pa kompletuar sepse ankuesi nuk ka deponuar tarifën e sigurimit të ankesës së tij siç kërkohet në pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së lidhur me nenin 118 të LPP-së.

Andaj procedura e shqyrtimit të kësaj ankese përfundon në këtë fazë duke e hedhur të njëjtën si jo e plotë ngase kjo ankesë nuk plotëson kushtet për tu proceduar më tutje siç kërkohet dispozitat ligjore të lartcekura.

Autoritetit kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme, mund të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit (e përshkruar me sipër) nëse nuk ka ankesë tjetër për këtë aktivitet. Paneli Shqyrtues megjithatë i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60, 65 të LPP-së.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, dhoma e shkallës së parë, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.

### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- **AK - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- **OE - NIKA PrO- Ing SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: